

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: EKO ING SH.P.K., MARTIN CAMAJ NR. 47/1 – PRIZREN Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	10.12.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **10.12.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **EKO ING SH.P.K.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEKORIMI I QYTETIT TË RAHOVECIT PËR FESTAT E FUND VITIT**, me Numër të prokurimit: **623-24-12444-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-066-2-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **EKO ING SH.P.K.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEKORIMI I QYTETIT TË RAHOVECIT PËR FESTAT E FUND VITIT**, me Numër të prokurimit: **623-24-12444-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-066-2-3-6**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **05.12.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-12444-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-066-2-3-6**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **EKO ING SH.P.K.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEKORIMI I QYTETIT TË RAHOVECIT PËR FESTAT E FUND VITIT**, me Numër të prokurimit: **623-24-12444-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-066-2-3-6**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **05.12.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **10.12.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042:

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua Ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të Pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se: 19,500.00 Euro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar në Kosovë;

Sqarimet janë si në vijim:

Ju si Operator Ekonomik nuk keni Ofruar Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK siç është kërkuar nga AK (pra Formularin CD) por keni ofruar një dokument të quajtur “Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera”. Bazuar në të dhënat e lartë përmendura dhe në mbështetje të nenit 59 paragrafit 4 të LPP-ës i cili përcakton si në vijim:
“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” AK ju informon se Tenderi juaj konsiderohet i papërgjegjshëm ngase nuk është në përputhshmëri kërkesën e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;

Gjithashtu ju si Operator Ekonomik nuk e keni përfillura Autoritetin Kontraktues të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht **Kapaciteti teknik dhe profesional, i cili ka kërkuar si në vijim:**

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet te posedoje Mjetet e punës ne dispozicion për realizimin e shërbimeve:

- Dy (2) Kamionë me auto shportë;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve

- Dy (2) Kamionë me auto shportë;

Duhet te dorëzoj dëshminë që janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik për realizimin e punëve dhe shërbimeve (dëshmitë me foto se mjetet janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik dhe Libreza e regjistrimit të automjetit e cila regjistrohet duhet te jete me afate te regjistrimit) ose Ne rast se Operatori Ekonomik nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët;

Pra edhe në këtë pikë Ju si Operator Ekonomik edhe pse keni ofruar një listë të mjeteve të njëjtës **nuk ju kanë bashkangjitur dëshmitë me foto ashtu siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues dhe për këtë arsye, AK-ja informon se edhe për këtë pikë, Tenderi juaj konsiderohet i papërgjegjshëm ngase nuk është në përputhshmëri kërkesën e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së;**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 citoj:

Kapacitetet ekonomike dhe financiare:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se: 19,500.00 Euro

Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë

Dëshmia e ofruar: Kjo pike është e përmbushur në plotni dhe nuk ka as një dilemë dhe kundërligjshëm është interpretuar nga ana e komisionit vlersues. Dokumenti 7 e ka emrimin: Gjendja e përgjithëshme e deklarimeve dhe e transaksioneve të tjera, që mbërthen në vete me transparence të plotë deklarimet vjetore detale për vitin 2022,2023,2024, dhe qarkullimin total. 178127.36 euro, Shiqo dokumenti nr.7 të ofertë dërguar në mënyrën elektronike

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1:

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit.

Në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit, tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është kërkuar: **Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar në Kosovë;**

Me Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ne kemi dhënë arsyeje për eliminimin tuaj, duke cekur: **Ju si Operator Ekonomik nuk keni Ofruar Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK siç është kërkuar nga AK (pra Formularin CD) por keni ofruar një dokument të quajtur "Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera"**

Përkatësisht sipas Njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit, nëse Operatori Ekonomik gjatë aplikimit dorëzon Deklarata Tatimore vjetore të dorëzuar në ATK, duhet të dorëzojë këtë formular:

Ky formular mund të shfrytëzohet vetëm për shembuj!



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



CD **FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PER TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE** UNIREF

[1] Periudha e Deklarimit:

[3] Numri Fiskal:

[4] Emri i tatimpaguesit:

[5] Adresa e tatimpaguesit:

[6] Pronari: Telefoni:

[7] Menaxheri: Telefoni:

[8] Kontabilisti/Mbajtësi i librave: Telefoni:

[9] Nëse deklarata tatimore është për të ndryshuar deklaratën e plotësuar më herët për të njëjten periudhë, vendose 'X' në kutinë që përshkruan llojin e ndryshimit. (Ju lutemi referohuni udhëzimit për plotësim)

Shese Korrigjim Vetëm pagese

Ndërsa ju si Operator Ekonomik, në ofertën e dorëzuar, keni prezantuar këtë formular:



Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera

NR. FISKAL:	810973819	TATIMPAGUESI:	JURIDIK
EMRI:	EKO ING SH.P.K.	REGJIONI:	PRIZREN I
ADRESA:	MARTIN CAMAJ NR.47/1		
LLOJI I KOMPANISË:	SH.P.K.	TEL:	043790700
AKTIVITETI:	Instalime elektrike		
NDD:	NDËRMARRJET	Adresa e Ndërmarrjes/ndësisë	Informarja kryesore
810973819	EKO ING SH.P.K.	MARTIN CAMAJ NR.47/1	Ndërmarrja kryesore
			START DATE: 07-12-2015
			CLOSE DATE:
			Lista e pronarve
			810973819

Tatimpaguesi është i regjistruar për këto lloje të tatimeve

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 citoj:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet te posedoje Mjetet e punës ne dispozicion për realizimin e shërbimeve

Dëshmit e ofruara:

• Dy (2) Kamionë me auto shportë; ale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve mjeteve te punës në dispozicion për realizimin

Dëshunia 1: Lista origjin e shërbimeve

• Dy (2) Kamionë me auto shportë;

Kjo pike është e tej përmbushur dhe nuk ka as një dilemë dhe kundërligjshëm është interpretuar nga ana e komisionit vlersues. Dokumenti dosje 5.1 mbërthen në vete me transparence të plotë Kamionë me auto shportë siq është kërkuar dhe ate me radhë:

1. Dok.1 Paisjet teknike në pronsi të OE "EKO ING" sh.p.k. kamionet dhe kamineta me korpë ku në dokumentin nr.5 ka lejen e qarkullimit e cila eshte leternjoftimi automjetit ku permban ne vete ngjyren numrin e shasis, numrin e targave, prodhuesin dhe llojin e automjetit qe si dokument relevante është I njoftun edhe nderkomtarishte.

2. Dok.3 Paisjet teknike e marrun në shfrytzim, në pronsi të personit juridik Bajram Kastrati nga fsh. Zatriq, e nenshkruar nga te dy palet. kamineta me korpë ku në dokumentin lejen e qarkullimit e cila eshte leternjoftimi automjetit ku permban ne vete ngjyren numrin e shasis, numrin e targave, prodhuesin dhe llojin e automjetit qe si dokument relevante është I njoftun edhe nderkomtarishte

3. Dok.4 Paisjet teknike e marrun në shfrytzim, në pronsi OE "MONTING"sh.p.k. Prishtinë nënshkruar dhe e vulosur nga dy palët. Bëhet fjalë për dy kamina me korpë ku në dokumentin lejen e qarkullimit e cila eshte leternjoftimi automjetit ku permban ne vete ngjyren numrin e shasis, numrin e targave, prodhuesin dhe llojin e automjetit qe si dokument relevante është I njoftun edhe nderkomtarishte.

[d.m.th.](#) në dispozicion janë katër autokorpa, me të dhëna detale dhe validitet të plotë.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2:

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit.

Me Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ne kemi dhënë arsyeje për eliminimin tuaj, duke cekur: *Ju si Operator Ekonomik edhe pse keni ofruar një listë të mjeteve të njëjtës nuk ju kanë bashkangjitur dëshmitë me foto ashtu siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues;*

							
		"EKO ING" SH.P.K					
		Lista e makinerisë					
Nr.r.		Viti i prodhimit	Lloji	Nr I tabelave	Ngjyra	Nr. Identifikues	Kapaciteti
1	Kamionet	2001	Volswagen	04-910-GC	E Bardh	WDB6023181P401785	2461
2	Auto-Kranl	1995	Mercedes-Benz	04-872-GL	E Bardh	WDB6023181P401786	2300

Tek Lista e Makinerive të Prezantuar nga ana juaj, janë dy (2) pajisje, ku nga dëshmia e ofruar ne bazë të dëshmimeve të prezantuara apo Libreza e regjistrimit të automjetit të dorëzuar në librezë është:

1. **Kamionetë Dubelkabina 3 Dyer**, Nr. i tabelave: **04-910-GC**, është me datë regjistrimi deri: **10-09-2019 me afat regjistrimi jo valid**, ndërsa nga dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar, Libreza e regjistrimit të automjetit e cila regjistrohet duhet te jete me afate te regjistrimit;
2. **Kamionetë me Korpë 2 Dyer**, Nr. i tabelave: **04-872-GL**, është me datë regjistrimi deri: **10-09-2025**;

Po ashtu në Ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar Marrëveshje me Kompaninë: **“MONTING” SH.P.K.** për dy (2) Pajisje: **Kamion me Shportë me Targa: 01-846-EN dhe 01-763-MT**;

Pra edhe në këtë pikë Ju si Operator Ekonomik edhe pse keni ofruar pajisje të mjeteve, por të njëjtës **nuk ju kanë bashkangjitur dëshmitë me foto ashtu siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues** dhe për këtë arsye, AK-ja informon se edhe për këtë pikë, Tenderi juaj konsiderohet i papërgjegjshëm ngase nuk është në përputhshmëri kërkesën e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 citoj:

Sa i perket tenderuesit OE “fitues” te cilit i eshte pregaditur paraprakishte ky tender nuk plotson minimumin bazuar ne pershkrimin shifrave te bizneseve qe i njejti i ushtron. OE “fitues” nuk ka ushtruar asnjehere nje veprimari te lemise te instalimeve dhe ndriqimeve elektrike. Shih pershkrimin e shifrave veprimtarive qe i ka te pershkruara ku, primare e ka prodhim te betonit dhe shifrat e tjera s’kan lidhje me kete veprimtari. Bazuar ne c’ka u tha ne tersi, linden medyshje se c’far synime kane protagonistet.

Bazuar si u tha më lartë me fakte relevante uroj që ky lëshim të mos jetë tendencioz.

Përgjigja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë ka plotësuar **Kërkesën Nr. 1 Përshtatshmëria profesionale**, sipas Njoftimin e kontratës dhe Dosjes së tenderit;

Në bazë të pretendimit tuja ankimor ku keni cekur *shifrat e tjera s’ka lidhe me këtë veprimtari*, në Dosjen e Tenderit nuk është cekur Fushë veprimtaria e Certifikatës, por Operatori Ekonomik ka prezantuar Certifikatën e Biznesit se bashku me informatat për Biznesit, ku ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit;

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

Po ashtu gjeni te bashkangjitur shkresat nga **Menaxheri i Kontratës** dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, por mos zbatimin e kontratës: **DEKORIMI I QYTETIT TË RAHOVECIT PËR FUNDVITË**, Numri i kontratës: **623-23-11935-2-3-6/C530**, për të njëjtin aktivitet të prokurimit.

Gjeni te bashkangjitur në këtë Vendim!

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Komuna e Rahovecit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraševac / Municipality Rahovec



Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), sipas kërkesës/ankesës e datës 08.04.2024 e Operatorit Ekonomik "EKO ING" sh.p.k., Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit më 16.04.2024 merr këtë:

PËRGJIGJE NË KËRKESË

1. Refuzohet kërkesa e datës 08.04.2024 e Operatorit Ekonomik "EKO ING" sh.p.k., në tërësi si e pa bazuar.
2. Mbetet në fuqi raporti i datës 23.02.2024 dhe raporti i datës 29.03.2024 i Menaxheri dhe Mbikëqyrësit të kontratës për projektin me titull "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fund vit" me numër të prokurimit: 623-23-11935-2-3-6.

Arsyetim

Komuna e Rahovecit si autoritet kontraktues dhe Operatori Ekonomik "EKO ING" sh.p.k. me seli në Prizren kanë nënshkruar kontratën e prokurimit publik për projektin me titull "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fund vit" me numër të prokurimit: 623-23-11935-2-3-6.

Operatori Ekonomik pas përfundimit të punimeve, i ka paraqitur kërkesë Autoritetit Kontraktues për pagesën e shumës së paraparë me kontratë në vlerën e tërësishtme të paraparë prej 3,895.00 €, duke i bashkëngjitur paramasat dhe specifikimet të parapara me këtë kontratë.

Menaxheri i kontratës Muharrem Morina dhe Mbikëqyrësi Afrim Dina sipas detyrës zyrtare, kanë përpiluar raportin më datën 23.02.2024, ndërsa bashkëngjitur këtij raportit kanë përgatitur raportin e situacionit, në të cilin janë përfshirë të gjitha veprimet për punën e kryer nga ana e Operatorit Ekonomik. Të njëjtit, kanë ardhur në përfundim se Operatori Ekonomik nuk i është përmbajtur në tërësi paramasave të kontratës së nënshkruar, prandaj duke u bazuar në punët e kryera pjesërisht të pranuar në vend si dhe në bazë të raportit, i kanë rekomanduar Zyrës së Financave që Situacioni i bashkëngjitur raportit të shkojë në pagesë për shumën prej 1,300.00 €, në emër të punëve të pranuar dhe punëve pjesërisht të kryera.

Më datën 29.03.2024, Menaxheri i kontratës Muharrem Morina dhe Mbikëqyrësi Afrim Dina i kanë dërguar Zyrës së Financave raport tjetër, me të cilin kanë konstatuar se Operatori Ekonomik nuk i ka kryer punimet sipas paramasave të cekura në kontratë dhe si rezultat ka ardhur deri te reagimi publik i qytetarëve dhe personave tjerë publikë për punën jo profesionale dhe me mangësi të theksuara, për çka në cilësinë e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit kemi kërkuar që të evitohen dështimet dhe që Operatori Ekonomik t'i përmbahet detyrës së kontratës për paramasat. Në fund, janë konstatuar shkeljet një pas njëslime procedurale të parapara me kontratë, siç janë: dështimi i parashtrimit të kërkesës me kohë për leje për vendosjen e dritave dekoruese; mos njohimi i organit kompetent për përfundimin e punimeve, dështim i implementimit të projektit sipas paramasave të parapara me

kontratë; dështim i izolimit të telave të furnizimit me rrymë dhe jashtë standardeve të sigurisë, duke rrezikuar jetën e fëmijëve dhe qytetarëve të tjerë; dështim i përmbushjes së pozicionit 6, 7 dhe 8 të kontratës, etj.

Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka arritur në përfundim se çdo vendosje ndryshe nga raportet e përshkruara, do të paraqiste keqpërdorim të parasë publike, meqenëse Operatori Ekonomik ka zbatuar kontratën vetëm pjesërisht, ndërsa ka dështuar ta zbatojë kontratën në pjesë tjera. Autoriteti Kontraktues-Komuna e Rahovecit përmes dështimit të zbatimit të paramasave të kontratës dhe shkeljeve serioze të kualitetit të punëve të kryera nga ana e Operatorit Ekonomik, ka pranuar kritika dhe ankesa të shumta nga ana e qytetarëve dhe personave publikë të Komunës së Rahovecit, për çka vërtetohet edhe me reagimet në portalet dhe mediat sociale.

Andaj, nga theksimet si më sipër, Autoriteti Kontraktues –Komuna e Rahovecit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e paraqitjes së padisë pranë Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi u dorëzohet:

- Operatori Ekonomik "FKO INCI" sh.p.k. me seli në Prizren,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Autoritetit kontraktues, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL - RAHOVEC
SKUPŠTINA OPŠTINE - ORAHOVAC

Drejtoria për punë inspektuese
Direkcija za Inspeksijske poslove

Inspektori Sherbimave Publike Inspektor - Ndërtimit

Nr. - Br. 02/2023

Data-Datum 22.12.2023.

PROCESVERBAL-ZAPISNIK
MBI KRYERJEN E MBIKQYRJES INSPEKTUESE
O IZVERŠENOM INSPEKCIJSKOM NADZORU

Pronari - investitori Inspektim sipas kërkesës së Drejtorisë së
Vlasnik - investitor Kulturës pranë KK Rrahovec, Vendlasja dhe

Inspektori - Inspektor "Xhevat Kasapi" Të pranishëm: - Prisutni:
KR - 0192 Muharem Abd. Morina
KR - 0068 049483166

Në procedurën e kontrollit inspektues të kryer më 22.12.2023 duke filluar në orën 9:20
U postpuku inspeksijske kontrole Izvršene dana 22.12.2023 sa početkom u 9:20

Inspektori Sherbimave Publike ka konstatuar këtë gjendje:
Inspektor Sherbimave Publike konstatovao je sledeće stanje


Në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Kulturës pranë
KK Rrahovec është dalur në terren për të kontrolluar në rrugën
"Xhevat Kasapi" dhe është konstatuar se kompania
EKO ING SH.P.K me përfaqësues ligjor Xhelal Kutaj dhe
shtet në rrugën "Martin Camë" nr. 4711 Prizren e cila ka
fituar lejetimin për ndërtimin e Kujetit të Rrahovecit të
në rrugën "Xhevat Kasapi" ka ndërmarr veprimet mbi
vendosjen e ndërgjimit dekorativ dhe shtarcisë së kabllove
ndërgjimesh në shtyllat e ndërgjimit publik të lidhurit për
furnizim me energji elektrike në rrugë" gjendje konform me standardet

Lidhur me gjendjen e gjetur para deklaroi:
U vëzi ndajenog stanja stranka Izjavi: gasi janë paragjitur ndërgjimit e rrjetit
ne rrugë min. dekorativ ne rr. "Xhevat Kasapi" se lidhurit në
shtyllat e ndërgjimit publik duk të jenë gjendje të izoluara të
është paragjitur rezultat i përgjithshëm.


URDHËRI I INSPEKSIONIT: Obliqohet që kompania të hartëdetur të ndërmarr
NALOG INSPEKCIJE: të gjitha veprimet mbi eliminimin e rezultit dhe defekteve

Inspektori urdhëron që parregullsitë e theksuar të menjahohen brenda afatit prej një ditësh-orësh
Inspektor nalaže da se uočene nedostatke otklone u roku od 1 dana-sati
në të kundërtën inspeksioni do të ndërmerr masa ligjore.
U suprotnom Inspekcija će preduzeti zakonske mere

Ky proces është përpiluar në tre ekzemplarë, prej të cilëve 1 i është dorëzuar palës.
Ovaj zapisnik sačinjen je u tri primerka, od kojih jedan je uručen stransi.

Pala - Stranka:


Përfunduar në orën 9:40
Zaveršeno u časova.

Inspektori - Inspektor:




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraševac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport
Odelenje za Kulturę, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport



13 Nr. Zyrtar - 2024

AK:	KOMUNA E RAHOVECIT
Data:	23.02.2023
Për:	Autoritetin Kontraktues – KOMUNA E RAHOVECIT, Zyrën e Financave – Komuna e Rahovecit
Nga:	Mënxheri i kontratës: <i>Muharrem Morina</i> Mblqyrtësi i Drejtëpërdrejt i mënxherit të kontratës: <i>Afrim Dina</i>
Punëkryesi:	Oponitorit Ekonomik: EKO ING SH.P.K
Tema:	Raport
Projekti:	Titulli: "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvit" Nr. prokurimi: 623-23-11935-2-3-6

Ky raport përfshin informata rreth procesit të punimeve për projektin:

Titulli: "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvit" të kontraktuar në mes të:

- Investitorit; Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport dhe - Kompanisë: EKO ING SH.P.K

Pas daljes në teren dhe verifikimit të punimeve konstatuam se Operatori Ekonomik EKO ING SH.P.K nuk e ka kryer punimet sipas Parametrit dhe Parametrit të paraqitura në mënyrë tabelare në Situacionin të paraqitur nga operatori.

Vlera e Kontratës është: 3.895 €

Mënxheri i kontratës ka përcjellë me kujdes punën në terren dhe në bazë të monitorimit të punimeve disa herë i është rekomanduar operatorit që të bëjë përmirësimet dhe të përmirësojë kontratën dhe parametret të paraqitura nga Institucionit. Duke i marrë për bazë vërejtjet që i kemi bërë në si institucion, vërejtjet nga qytetari dhe portalet lokale konstatojmë se Kompania në fjalë nuk ju ka përmbajtur në tërësi parametret të kontratës së nëshkruar për të cilën është pajtuar edhe vot operatorit ekonomik.

Prandaj duke u bazuar në punët e kryera në teren, si dhe në bazë të raportit, i rekomandojmë Zyrës së financave që ky Situacion të shkojë për pagesë.

Pozicioni 1.	600 x 1.80	1080 €
Pozicioni 2.	10 x 10	100 €
Pozicioni 3.	15 x 1.80	27 €
Pozicioni 4.	15 x 5	75 €
Pozicioni 5.	X	N/A
Pozicioni 6.	X	N/A

Pozicioni 7.	X	N/A
Pozicioni 8.	X	N/A
Pozicioni 9.	10 x 1.80	18 €
Pozicioni 10.	X	N/A

Vlera për pagesë 1300 € (Një mijë e treqind euro)

- Raporti i bashkëngjeshim:
- Situacionin përfundimtar

Mbikqyrësi i menaxherit të kontratës:


Afrim Dina



Menaxheri i kontratës:
Muhareze Shorina

Raporti i situacionit						
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia e Përafërt e Planifikuara	Çmimi për njësi	Totali	Të minusuara
1	Ecurizimi, montimi dhe mbledhja e ditave dekorative ngjyrë të verdhë të ngrohës. Vërehje: dridat duhet të jetë e punuar me kabllo prej gome me mbrojtje IP44. Dridat të vendosen në rënd përjat rregës çdo 30cm-400cm siq e cakton menagjeri i kontratës, çdo e 10-ta llombë të jetë me blle	copë	1000	1,800	1 800,00	1080 euro
2	Dekorimi i shtyllave elektrike të ndriqimit të qytetit	copë	50	10,000	500,00	100 euro
3	Dekorimi i pemëve dekorative në qytet. Vërehje: dridat duhet të jetë e punuar me kabllo prej gome dhe të jetë me ngjyrë të verdhë të ngrohës.	copë	50	1,800	90,00	27 euro
4	Furnizimi me kabllo 2*1.5m për të furnizuar dridat dekorative.		15	5,000	75,00	75 euro
5	Furnizimi dhe vendosja e dritave led ngjyrë të bardhë në qendër të qytetit, në llogari duhet të parashihet edhe vendosja e sajtes (litareve) nga shtylla në shtyllë në të cilat pastaj do të shtrahohen dridat, siq është parashikuar në foto.	copë	15	20,000	300,00	N/A
6	Dekorimi i rrugëve të qytetit të bashkuar me drita LED ngjyrë të bardhë të përpunueshme nga uji. Dridat duhet të vendosen në largësi çdo 8m. Duhet të parashihet shtangimi i tyre në shtyllat e ndriqimit të qytetit dhe në shtyllat e kabllove të energjisë elektrike, me qerç në largësi e shtyllave është ins e madhe se 8m në llogari duhet të parashihet vendosja e litareve (sajtes) nga shtylla në shtyll dhe pastaj të bëhet shtangimi i dritave në ato litare (sajtes), si në foto	copë	20	10,000	200,00	N/A
7	Furnizimi, furnizimi dhe vendosja e figurës dekorative me lartësi 1.00m e investuar së tash me drita të imetë led ngjyrë të verdhë të ngrohës ose të bardhë.	copë	15	10,000	150,00	N/A
8	Vendosja e brendit "Natura" gjatësinë 6 m diametri në fund të brendit 3 m, në qendër duhet të llogaritet montimi i brendit, vendosja e të gjitha pjesëve	copë	1	500,000	500,00	N/A

	maksimal të bredhit.					
9	Elemente dekorative në formë të ziles për vendosjen në brendi me dimensione min 20x30cm deri në 25x35 cm. Të jenë me delta me ngjyrë të verdhë ose ngjyrë kuqe.	copë	100	1,800	180,00	18 euro
10	Furazimi dhe monimi 1 figurave dekorative me led e cilat vendosen në mes të rrugës. Vercjtje të vendoset sajtë ose. Htar që të varen në mes të rrugës.	copë	10	10,000	100,00	N/A
			Total:		3 895,00	1300 EURO



Afrim Dina

From: Muharem A. Morina
Sent: Friday, March 29, 2024 1:04 PM
To: info.ekoing@gmail.com
Cc: Afrim Dina
Subject: PERSHENDETJE
Attachments: 29.03.2024.pdf

AK:	KOMUNA E RAHOVECIT
Data:	29.03.2024
Për:	Autoritetin Kontraktues KOMUNA E RAHOVECIT, Zyrën e Financave – Komuna e Rahovecit
Nga:	Menaxheri i kontates: <i>Muharem Morina</i> Mbikqyrësi i Drejtëpërdrejt i menaxherit të kontratës: <i>Afrim Dina</i>
Punëkryesi:	Operatorit Ekonomik: EKO ING SLLP.K
Tema:	Raport
Projekti:	Titulli: "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvit" Nr. prokurimi: 623-23-11935-2-3-6

Menaxheri i kontrates ka përcjellë me kujdes punën në terren dhe në bazë të monitorimit të punimeve disa herë i është rekomanduar operatorit që ti bëjë permisimet dhe ti përmbahet kontrates dhe paramasave të parapara nga institucioni . Duke i marrë për bazë vërejtjet që i kemi bërë ne si institucion, vërejtjet nga qytetarët dhe portalet lokale konstantojmë se Kompania në fjalë nuk ju ka përmbajtur në tërsi paramasave të kontrates së nëshkruar për të cilën është pajtuar edhe vet operatori ekonomik.

Sa i përket kundërshtimit tuaj të cekur si "Ashtëquajtur Raport" ju rikujtoj që ky është raport zyrtar nga institucioni përkatës dhe nuk ka as edhe një pike tendencë por është i bazuar në monitorimin e punimeve në teren.

Ju e dini mirë që me datë 01.02.2024, kemi kontaktuar për mes viberit me datë 15.02.2024, e kemi dërguar situacionin përfundimtar të punimeve për mbylljen e projektit në fjalë si mëngajer i kontrates e kam analizuar dhe kemi ardhur në përfundim që ky situacion nuk është real dhe ju i kemi të specifikuar sipas pozicioneve në raportin paraprak të datës 23.02.2024 (mbase është lëshuar një gabim teknik të viti kalendarik 2023)

Kur ju si operator ekonomik nuk i keni përfunduar punimet sipas paramasave të cekur në kontratë si është e mundur të keni bërë punë shtesë në projekt kjo nuk qëndron. Nëse e keni fjalën për piramidën e improvizuar si brendë aty është punuar në mënyrë vullnetare nga disa të rinjë dhe nga ju është bërë furnizimi me drita dekoruese dhe furnizimi me energji elektrike .

Ju si operator ekonomik nuk i keni përfillur procedurat si pas kontrates:

1. Nuk keni bërë kërkesë për leje në Komunë për vendosjen e dritave dekoruese
2. Nuk e keni njoftuar organin kompetent për përfundimin e punimeve
3. Nuk e keni implementuar projektin sipas paramasave të parapara në kontratë

4. Keni shfrytëzuar asetet e Komunes dhe keni vendosur paisje te perdorura për dekorim të qytetit
5. Keni rrezikuar jetën e qytetarve duke i lënë telat e rrymës të pa izoluar në shtyllat e ndriqimit publik.
6. (**Pozicioni 6**) nuk e keni bërë dekorimin e 50 shtyllave të ndriqimit publik sipas paramases së parapare. Dekorimi i rrugëve të qytetit të Rahovecit me drita LED ngjyr të bardhë (e papershkueshme nga uji) . Dritat duhet te vendosen ne largesi qdo 8m. Duhet te parashihet shtangimi i tyre ne shtyllat e ndriqimit te qytetit dhe ne shtyllat e kabllave te energjis elektrike, me qene se largesia e shtyllave eshte me e madhe se 8m në llogari duhet te parashihet vendosja e litareve (sajles) nga shtylla ne shtyll dhe pastaj te bëhet shtangimi i dritave ne ata litar (sajle)
7. (**Pozicioni 7**) nuk janë vendosur figurat dekorative me madhësi 1m që janë të parapara në paramasë Punimi, furnizimi dhe vendosja e figures dekorative me lartësi 1.00m e mveshur e tera me drita te imeta flet ngjyr të verdhë të ngrhtë ose të bardhë.
8. (**Pozicioni 8**) bredhi i vendosur nga ana juaj nuk ka qenë sipas paramasave 6m lartë dhe nuk është bërë rrethi me dimensione 3 m gjërsi në tokë. Vendosja e bredhit Natyral gjatësia 6 m diametri në fund të bredhit 3 m , në çmim duhet të llogaritet montimi i bredhit, vendosja e të gjitha pjesëve dekorative deri në kompletimin maksimal të bredhit.

Prandaj duke u bazuar në punët e kryera në teren, materialeve të vendosura dhe monitorimit të punëve në teren, ku operatori ekonomik i cekur më lartë nuk i ka përfunduar punimet sipas paramases dhe kontrates në mënyrë që të ruhet paraja publike bazuar në raportin e nxjerrë, i rekomandojmë Zyrës së financave që ky Situacion të shkoj për pagesë në:

Vlerë për pagesë 1300 € (Një mijë e treqind euro)

Operatori ekonomik është i obliguar ta sjell futuren për pagesë

- **Vërejtje:** Të bashkëngjitur i gjeni edhe materialet si deshmi fotot i keni të bashkëngjitura në raport



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rilindje dhe Sport



Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport

13 Nr. Zyrtar -- 2024

AK:	KOMUNA E RAHOVECIT
Data:	29.03.2024
Për:	Autoritetin Kontraktues - KOMUNA E RAHOVECIT, Zyra e Financave - Komuna e Rahovecit
Nga:	Menaxheri i kontratës: <i>Muharem Morina</i> Mëkqyrësi i Drejtëpërdrejt i menaxherit të kontratës: <i>Ajdin Dina</i>
Punëkryesi:	Operatorit Ekonomik: EKO INCI S.H.P.K
Tema:	Raport
Projekti:	Titulli: "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për lindvit" Nr. prokurimi: 623-23-11935-2-3-6

Menaxheri i kontratës ka përcjellë me kujdes punën në terren dhe në bazë të monitorimit të punimeve disa herë i është rekomanduar operatorit që të bëjë permisimet dhe të përmbahet kontratës dhe paramasave të parapara nga institucioni. Duke i marrë për bazë vlerëtimet që i kemi bërë ne si institucion, vërejtjet nga qytetarët dhe portalet lokale konstantojmë se Kompania në fjalë nuk ju ka përmbajtur në tërësi paramasave të kontratës së nënkryer për të cilën është pajtuar edhe vet operatorit ekonomik.

Sa i përket kundërshtimit tuaj të cekur si "Ashtëqajtur Raport" ju rikujtojmë që ky është raport zyrtar nga institucioni përkatës dhe nuk ka as edhe një pikë tendence për është i bazuar në monitorimin e punimeve në terren.

Ju e dini mirë që me datë 01.02.2024, kemi kontaktuar për mes viberit me datë 15.02.2024, e kemi dërguar situacionin përfundimtar të punimeve për mbylljen e projektit në fjalë si mëngajer i kontratës e kam analizuar dhe kemi ardhur në përfundim që ky situacion nuk është real dhe ju i kemi të specifikuar sipas pozicioneve në raportin paraprak të datës 23.02.2024 (mbase është lexuar një gabim teknik të viti kalendarik 2023)

Kur ju si operator ekonomik nuk i kemi përmbajtur punimet sipas paramasave të cekur në kontratë si është e mundur të kemi bërë punë shtesë në projekt kjo nuk qendron. Nëse e kemi fjalën për piramidën e improvizuar si bredit aty është punuar në mënyrë vullnetare nga disa të rinjtë dhe nga ju është bërë furnizimi me dritha dekoruese dhe furnizimi me energji elektrike.

Ju si operator ekonomik nuk i kemi përfillur procedurat si pas kontratës:

1. Nuk kemi bërë kërkesë për leje në Komunë për vendosjen e drithave dekoruese
2. Nuk e kemi njoftuar organin kompetent për përfundimin e punimeve
3. Nuk e kemi implementuar projektin sipas paramasave të parapara në kontratë
4. Kemi shfrytëzuar asetet e Komunës dhe kemi vendosur pajsje të përdorura për dekorim të qytetit
5. Kemi rrezikuar jetën e qytetarëve duke i lënë telat e rrymës të pa izoluar në shtyllat e ndriçimit publik.


6. (Pozicioni 6) nuk e kemi bërë dekorimin e 30 shtyllave të ndriçimit publik sipas paramasës së paraparaç Dekorimi i rrugëve të qytetit të Rahovecit me drita LED ngjyrë bardhë të papërshtueshme nga uji . Dritat duhet të vendosen në lartësi qdo 8m. Duhet të parashihet shtingimi i tyre në shtyllat e ndriçimit të qytetit dhe në shtyllave kabllorëve të energjis elektrike, me qenë se largësia e shtyllave është me e madhe se 8m në llogari duhet të parashihet vendosja e litareve (sujles) nga shtylla në shtyll dhe përfundim të hollët shtingimi i dritave në ato llat (sajle)
7. (Pozicioni 7) nuk janë vendosur figurat dekorative me madhësi 1m që janë të parapara në paramasë Punimi, furnizimi dhe vendosja e figurave dekorative me lartësi 1.00m e investuar e toq me drita të metra lled ngjyrë të verdhë të ngrohtë orë të bardhë.
8. (Pozicioni 8) brendhi i vendosur nga ana tjetër nuk ka qenë sipas paramasave 6m lartë dhe nuk është bërë rrethi me dimensione 3 m gjërsi në tokë. Vendosja e brendhit Natyral gjatësia 6 m diametri në fund të brendhit 3 m , në qimin duhet të llogaritet montimi i brendhit, vendosja e të gjitha pjesëve dekorative deri në kompletimin maksimal të brendhit.


Prandaj duke u bazuar në punët e kryera në teren, materialeve të vendosura dhe monitorimit të punëve në teren, ku operatori ekonomik i ockur më lartë nuk i ka përfunduar punimet sipas paramasës dhe kontratës në mënyrë që të rihet paraja publike huzuar në raportin e nxjerrë, i rekomandojmë Zyrtës së Financave që ky Situasion të shkoj për pagesë në:


Vlerë për pagesë 1300 € (Një mijë e treqind euro)


Operatori ekonomik është i obliguar ta sjell fituren për pagesë

- Vërejtje: Të bashkëngjitur i gjoni edhe materialet si desini fotot i kemi të bashkëngjitura në raport .





















Burim Krasniqi • Follow

22 Dec 2023 • 🌐

Qytetar, kujdes fëmijët!

"Dekorimi" i qytetit të Rahovecit mund ... See more





Rahoveci Jonë



Rahoveci Jonë

1h · 🌐

...

Na'u largua edhe një hall, Rahoveci më në fund me brech european 🇪🇺




Rahoveci n'Fokus · Follow

2h · 🌐

Nuk është Stockholmi, por Rahoveci! 🇪🇺


© 🇪🇺 [Raho Gazeta]



Raporti i situacionit						
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia e Përafërt e Planifikuara	Çmimi për njësi	Totali	Vë rejtë minusuara
1	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese ngjyrë e verdhë të ngrohtë. Vërejtje: dritat duhet të jenë e punuar me kabllo prej gome me mbrojtje IP44. Dritat të vendosen në vend përgjat rrugës që shtrihet në afërsisht 10-ta llambë të jetë me bluc	copë	1000	1,800	1 800,00	1080 euro
2	Dekorimi i shtyllave elektrike të ndriqimit të qytetit	copë	50	10,000	500,00	100 euro
3	Dekorimi i pemëve dekorative në qytet. Vërejtje: dritat duhet të jenë e punuar me kabllo prej gome dhe të jenë me ngjyrë të verdhë të ngrohtë.	copë	50	1,800	90,00	27 euro
4	Furnizimi me kabllo 2*1.5m për të furnizuar dritat dekorative.		15	5,000	75,00	75 euro
5	Furnizimi dhe vendosja e dritave led ngjyrë e bardhë në qendër të qytetit, në llogarë duhet të parashihet edhe vendosja e sajleve (litareve) nga shtylla në shtylla në të cilat pastaj do të shtangohen dritat, siq është parashikuar në foto.	copë	15	20,000	300,00	N/A
6	Dekorimi i rrugëve të qytetit të Rahovecit me drita LED ngjyrë të bardhë në papërshkueshëm nga uji. Dritat duhet të vendosen në largësi që 3m. Duhet të parashihet shtangimi i tyre në shtyllat e ndriqimit të qytetit dhe në shtyllat e kabllove të energjisë elektrike, me qene se largësia e shtyllave është me e madhe se 8m në llogarë duhet të parashihet vendosja e litareve (sajle) nga shtylla në shtyll dhe pastaj të bëhet shtangimi i dritave në ato llogarë (sajle) si në foto.	copë	20	10,000	200,00	N/A
7	Punimi, furnizimi dhe vendosja e figurës dekorative me lartësi 1.00m e rrethuar e tëra me drita të imceta led ngjyrë të verdhë të ngrohtë ose të bardhë.	copë	15	10,000	150,00	N/A
8	Vendosja e bardhit Natyral gjatësia 6 m (shprehur në fund të bardhit 3 m, në çeliku duhet të fuzaritet montimi i bardhit, vendosja e të gjitha pjesëve	copë	1	500,000	500,00	N/A

	maksimial të brendshme.					
9	Elemente dekorative në formë të ziles për vendosjen në brendshme me dimensione min 20x30cm deri në 25x35 cm. Të jenë me dritë dhe ngjyrë të verdhë ose ngjyrë të kuqe.	copë	100	1,000	180,00	18 euro
10	Furazimi dhe montimi i figurave dekorative me lesh e cila vendosen në mes të rrugës. Vërejtje të vëndaest sajtë ose turr që të vëron në mes të rrugës.	copë	10	10,000	100,00	N/A
			Total:		3.895,00	1300EURO

Menaxheri i kontratës:
Muharem Murina



KOMUNA E RAHOVECIT¹

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës¹: 623-23-11935-2-3-6/C530

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njëvën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: EKO ING SH.P.K., MARTIN CAMAJ NR.47/1, PRIZREN, 601555165, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara më poshtë:

Titulli i Kontratës: DEKORIMI I QYTETIT TË RAHOVECIT PËR FUNDVITË

Me numër identifikues: 623-23-11935-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Dekorimi i Qytetit të Rahovecit për fundvitë, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata lypset në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 30 ditë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [10] nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi për kryerjen e shërbimeve është: NË KOMUNËN E RAHOVECIT

1.5 Incentivi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykatë përkatëse në Prishtinë.

¹ Ju lutemi referojuuni zgjedhjen e numrit të kontratës në dokumentet e futurimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thirrjen.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 3,895.00 Euro;

[Treni]ë e tetëqindëntëdhjetepesë Euro

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e veimja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh shërbimet sipas kontratës.

3.3 Ai duhet të jetë i prarë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilin shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debiteti llogaritur e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thotëbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatinin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrimet tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të rrebelat valid për... muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Shuma e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilin ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrinë kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontrakt do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të oftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Përshkrimi i Çmimeve - Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvitë

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1.	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese ngjyrë e verdhë të ngrohtë. Vërejtje drita duhet të jetë e punuar me kablo prej gome me mbrojtje IP44. Dritat të vendosen në rend përgjat rrugës çdo 50cm-100cm siq e cakton menagjeri i kontratës, çdo e 10-ta llambë të jetë me bluc	copë	1000.00	1.80	1800.00
2	Dekorimi i shtyllave efektive të ndriqimit të qytetit	copë	50.00	10.00	500.00
3	Dekorimi i pemëve dekorative në qytet. Vërejtje dritat duhet të jetë e punuar me kablo prej gome dhe të jenë me ngjyrë të verdhë të ngrohtë.	copë	50.00	1.80	90.00
4	Furnizimi me kabull 2*1.5m për të furnizuar dritat dekorative.	copë	15.00	5.00	75.00
5	Furnizimi dhe vendosja e dritave led ngjyrë bardhë në qendër të qytetit, në llogari duhet të parashihet edhe vendosja e sajleve (litareve) nga shtylla në shtyllë në të cilat pastaj do të shtangohen dritat, siq është paraqitur në foto.	copë	15.00	20.00	300.00
6	Dekorimi i rrugëve të qytetit të Rahovecit me drita LED ngjyrë të bardhë të papërshkuoshme nga uji. Dritat duhet të vendosen në largësi çdo 8m. Duhet të parashihet shtangimi i tyre në shtyllat e ndriqimit të qytetit dhe në shtyllat e kablove të energjisë elektrike, me qene se largësia e shtyllave është më e madhe se 8m në llogari duhet të parashihet vendosja e litareve (sajles) nga shtylla në shtyll dhe pastaj të bëhet shtangimi i dritave në ata litar (sajle), si në foto	copë	20.00	10.00	200.00
7	Punimi, furnizimi dhe vendosja e figures dekorative me lartësi 1.00m e rrvëshur e tera me drita të imeta led ngjyrë të verdhë të ngrohtë ose të bardhë.	copë	15.00	10.00	150.00
8	Vendosja e bredhit Natyral gjatësia 6 m diametri në fund të bredhit 3 m, në çmim duhet të llogaritet montimi i bredhit, vendosja e të gjitha pjesëve dekorative deri në kompletimin maksimal të bredhit,	copë	1.00	500.00	500.00
9	Elemente dekorative në formë të zllës për vendosjen në bredh me dimensione min 20x30cm deri në 25x35 cm. Të jenë me drita me ngjyrë të verdhë ose ngjyrë e kuqe.	copë	100.00	1.80	180.00
10	Furnizimi dhe montimi i figurave dekorative me led e cila vendosen në mes të rrugës. Vërejtje të vendoset sajlë ose litar që të varen në mes të rrugës.	copë	10.00	10.00	100.00
				Totali:	3895.00

VËREJTJE: Pas përfundimit të ditëve festive duhet të bëhet demontimi i të gjitha elementeve dekorative të cilat pastaj do të shkojnë në pronari të Komunitetit të Rahovecit

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i jepë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatit e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) In jop dikujt kontratën apo nëkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Fallimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqot ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forezës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë; për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore





13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitral.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të luhet gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin si identifikim, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Ofruesin e Shërbimit:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Xhelal Kukaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.12.2023	Data:	05.12.2023
Vula:		Vula:	

³ Gjitha do të jenë gjitha e përdorur nga tenderuesit në tenderit e tij.